

FOL

RAPORT MBI
MONITORIMIN E
PROCESEVE TË
PËRZGJEDHJES
SË KANDIDATËVE
PËR POZITA
PUBLIKE

RAPORT MBI MONITORIMIN E PROCESEVE TË PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE PËR POZITA PUBLIKE

MARS, 2022

Titulli: Raport mbi Monitorimin e Proceseve të Përzgjedhjes së Kandidatëve për Pozita Publike

Autore: Lëvizja FOL

Viti i botimit: Mars 2022

Publikuar nga: Lëvizja FOL

Andrea Gropa nr.35

Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

info@levizjafol.org

+383 (0)49 131 542

FOL



Të drejtat e autorit © 2022. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Ky projekt u financua nga granti i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur. Opinionet, gjetjet dhe përfundimet e shprehura në këtë raport janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e KFOS-it.

PËRMBAJTJA

HYRJE	2
KORNIZA LIGJORE	4
PROCESI I PËRZGJEDHJES SË DREJTORIT TË AGJENCISË KUNDËR	
KORRUPSION (AKK)	6
PROCESI I PËRZGJEDHJES SË TRE (3) ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË	
PAVARUR PËR MEDIA (KPM)	10
PROCESI I PËRZGJEDHJES SË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË RADIO	
TELEVIZIONIT TË KOSOVËS (RTK)	13
PROCESI I PËRZGJEDHJES SË DY (2) ANËTARËVE TË KËSHILLIT GJYQËSOR TË	
KOSOVËS (KGJK)	16
REKOMANDIME	17

HYRJE

Lëvizja FOL është organizatë jo qeveritare, e cila në fokus të saj e ka rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike në vend. Që nga viti 2019, Lëvizja FOL ka filluar monitorimin e proceseve të rekrutimit të pozitive të larta shtetërore nga institucionet kompetente, qëllimi i të cilit është ndjekja e mbarëvajtjes dhe zhvillimit të procedurave parlamentare, duke ndikuar në ngritjen e llogaridhënies dhe transparencës së këtyre proceseve.

Përzgjedhja e personave meritore dhe kompetent në institucionet publike, duke u bazuar në parimet e transparencës, llogaridhënies dhe barazisë së kandidatëve, padyshim se do të ndikoj në ngritjen e performancës dhe kredibilitetit të institucioneve publike përkatëse.

Në këtë raport janë përfshirë gjetjet nga monitorimi i procesit të përzgjedhjes së Drejtorit të Agjencisë kundër Korrupsion, i tre (3) anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, i dy (2) anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe gjetjet nga monitorimi i procesit të përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të Radio Televizionit të Kosovës.

Për monitorimin e këtyre proceseve, FOL fillimisht ka kërkuar qasje në aplikacionet e kandidatëve që kanë aplikuar. Këto aplikacione janë analizuar hollësisht sa i përket përmbushjes së kriterëve ligjore dhe formale për të aplikuar në këto pozita dhe për të vazhduar me fazat tjera. FOL gjithashtu ka marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e komisioneve përgjegjëse për përzgjedhjen e këtyre pozitave¹, që nga fillimi i intervistimit deri në përfundimin e poentimit nga ana e panelit intervistues, si dhe ka përcjellë votimin e tyre në seancën e Kuvendit të Kosovës, si dhe në mbledhjet e institucioneve përgjegjëse për përzgjedhjen e tyre.

Në vazhden e monitorimeve që Lëvizja FOL ka bërë gjatë vitit 2021, pra, ka qenë monitorimi i përzgjedhjes së Drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsion (AKK). Ky organ i pavarur dhe i specializuar për ndjekjen e politikave shtetërore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovës, kishte mbetur pa drejtor që nga 24 shtatori i vitit 2021. Kjo për shkak se ish-drejtorit të këtij institucioni, Z. Shaip Havollit, i kishte skaduar mandati.

Anëtarët e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit kishin vendosur që për këtë pozitë nuk mund të zgjedhin ndonjë ushtrues detyre, duke e lënë këtë pozitë të zbrazët deri në zgjedhjen e drejtorit të ri.

¹ Me përjashtim të procesit për përzgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së, ku siç është shpjeguar edhe në raport, Bordi i RTK-së nuk kishte dërguar njoftim në lidhje me datën e mbajtjes së testeve.

Ndër proceset e rekrutimeve që FOL ka monitoruar gjatë këtij viti, ishte edhe monitorimi i përzgjedhjes së tre anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media (KPM-së).

KPM është organ kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit në Republikën e Kosovës. Roli i saj në mbrojtjen e lirisë së shprehjes, shumëllojshmërisë e mendimit, qasjes në informata për gazetarë dhe publikun, si dhe interesin e shfrytëzuesve të mediave dhe operatorëve sipas sundimit të ligjit, është më se i rëndësishëm. Gjithashtu KPM ka për vizion të inkurajojë profesionalizmin në radhët e gazetarëve, menaxherëve dhe pronarëve të mediave, si dhe të promovoj zhvillimin e një tregu të shëndoshë medial që u shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Prandaj, monitorimi i mbarëvajtjes së procesit të rekrutimit të anëtarëve të KPM-së është parë si aktivitet shumë i rëndësishëm. Bazuar në nenin 10 të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave², anëtarët e KPM-së duhet të jenë personalitete të dalluara të fushave të ndryshme si: kultura, arti, drejtësia, kinematografia, gazetaria, biznesi, menaxhmenti, marrëdhënie me publikun, marrëdhënie ndërkombëtare, media dhe teknologjia informative; duhet të jenë individë me kredibilitet dhe autoritet të lartë njerëzor, profesional dhe moral; duhet të jenë plotësisht të përkushtuar, objektiv dhe të paanshëm; po ashtu, anëtarëve të KPM-së u ndalohet keqpërdorimi i pozitës së tyre për përfitim personal apo të familjes së tij të ngushtë, të ndonjë pale apo të entitetit tjetër.

Përmes kërkesave të drejtuara Zyrës Koordinuese të Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media, FOL ka arritur të jetë ndër monitoruesit e këtij procesi. Ky proces është monitoruar me pjesëmarrje direkte, do të thotë, FOL ka monitoruar dy takime të Komisionit dhe intervistimin e kandidatëve të cilët kanë aplikuar për anëtarë.

FOL gjithashtu ka monitoruar edhe procesin e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të Radio Televizionit të Kosovës. Mirëpo, meqenëse FOL nuk kishte pranuar ndonjë njoftim nga Bordi i këtij institucioni në lidhje me kohën e mbajtjes së testeve, FOL kishte arritur të monitoroj vetëm fazën fillestare dhe fazën e intervistave të këtij procesi. Duke ditur rëndësinë e madhe të këtij institucioni, FOL monitorimin e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të këtij mediumi publik e ka parë më se të rëndësishëm.

Në fund të raportit është përshkruar edhe procesi i përzgjedhjes së dy (2) anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radhët e komuniteteve, një nga komuniteti serb dhe një nga komuniteti tjetër jo shumicë.

² Kuvendi i Republikës së Kosovës: LIGJI Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, 2012

KORNIZA LIGJORE

Sigurimi i transparencës institucionale, respektimi i dispozitave ligjore dhe vlerave të qeverisjes së mirë në Komisionet e Kuvendit të Kosovës, si dhe në institucionet tjera për vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në konkurset për pozita publike, paraqiten si elemente të rëndësishme të garantimit të meritokracisë. Zgjidhjet ligjore që jep legjislacioni pozitiv i Republikës së Kosovës kërkojnë që për disa pozita të caktuara publike të parashihen procedura të veçanta të mbarëvajtjes së konkurseve publike duke i zhvilluar në sajë të kompetencës dhe mbikëqyrjes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, apo të institucioneve tjera përkatëse.

Procedura e zgjedhjes së drejtorit të Agjencisë kundër Korrupsion (AkK), duke përfshirë edhe kompetencat dhe përgjegjësit e tij, rregullohet hollësisht me Ligjin për Agjencinë kundër Korrupsion.³ Agjencia kundër Korrupsion, pra, udhëhiqet nga drejtori, i cili ka mandat 5 vjeçar dhe mund të rizgjidhet vetëm edhe për një mandat tjetër. Drejtori ka këto kompetenca dhe përgjegjësi: të udhëheq dhe organizoj punën e Agjencisë; të mbikëqyr punën e nëpunësve të Agjencisë; të përfaqësoj Agjencinë brenda dhe jashtë vendit; të menaxhoj buxhetin e Agjencisë; të lidh marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare; të vendos për angazhimin e ekspertëve jashtë Agjencisë, si dhe të ushtroj edhe detyra të tjera të përcaktuara me ligj.⁴

Gashtë muaj para skadimit të mandatit të Drejtorit të Agjencisë, Komisioni informon Kuvendin e Kosovës në mënyrë që të fillojë procedurën për zgjedhjen e Drejtorit të ri. Kandidati për Drejtor të Agjencisë duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme: të jetë shtetas i Republikës së Kosovës dhe të ketë vendbanim të përhershëm në Kosovë; të ketë së paku diplomë universiteti katërvjeçar ose master; të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale; të ketë integritet të lartë moral; të ketë së paku 5 vite përvojë pune profesionale.⁵

Ndërkaq sipas nenit 8 të Ligjit për Agjencinë Kundër Korrupsionit, përcaktohet se procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve më të mirë menaxhohen nga komisioni, ndërsa dy prej të cilëve janë vlerësuar si më të suksesshëm i propozohen kuvendit për votim.

Sa i përket anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, procedura e zgjedhjes së tyre është përcaktuar me Ligjin për Komisionin e Pavarur për Media.⁶ Sipas nenit 11 të këtij ligji, Anëtarët e KPM-së emërohen nga Kuvendi i Kosovës në bazë të procedurave të hapura dhe transparente, sipas kësaj procedure: *brenda 60 ditësh para kalimit të mandatit të anëtarit të KPM-së apo pas shpalljes së vendit të lirë për arsye të tjera, KPM nxjerr shpalljen publike, brenda një periudhe jo më të shkurtër*

³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsion.

⁴ Po aty, neni 11.

⁵ Po aty, neni 8, par.3.

⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/l-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave.

se afati i përcaktuar me ligj. Kandidaturat e pranuar shqyrtohen nga një Komision ad – hoc i Kuvendit të Kosovës, ndërsa brenda periudhës kohore prej 21 ditësh pas përfundimit të afatit për paraqitjen e kandidaturës, komisioni ad-hoc, pas intervistimit i rekomandon 2 kandidatë për çdo pozitë të anëtarit të KPM-së, për të cilët konsideron se janë më të përshtatshmit në bazë të kompetencave, përgatitjes profesionale integritetit dhe përkushtimit të tyre për fushëveprimin e KPM-së. Bazuar në Rregulloren e punës së Kuvendit, Kuvendi zgjedh njërin nga kandidatët e rekomanduar me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë.⁷

Çështja e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të Radio Televizionit të Kosovës (RTK) rregullohet detajisht me Ligjin për Radio Televizionin e Kosovës.⁸ Sipas nenit 32 të këtij ligji, Drejtorin e Përgjithshëm të RTK-së e emëron Bordi i RTK-së. Drejtori i Përgjithshëm duhet të jetë shtetas i Republikës së Kosovës dhe person me përvojë të menaxhimit të medieve apo fushave tjera relevante. Drejtori i Përgjithshëm i RTK-se emërohet dhe shkarkohet me 2/3 e votave të anëtarëve të Bordit. Mandati i tij do të jetë 3 vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes në bazë të konkursit, vetëm edhe për një mandat pasues.⁹

Drejtori i Përgjithshëm i këtij mediumi publik ka këto kompetenca dhe përgjegjësi: menaxhon veprimtarinë e RTK-së në pajtim me këtë ligj dhe me statutin e RTK -së, si dhe me Kodin Etik të RTK - së, zgjedh dhe shkarkon personelin e RTK-së në përputhje me ligjet që rregullojnë marrëdhëniet e punës, Ligjin e RTK-së dhe Statutin e RTK-së; merr vendim lidhur me çështjet e organizimit, financave dhe pagave, në bazë të kriterëve të përcaktuara nga Bordi i RTK-së; e përfaqëson RTK-në brenda dhe jashtë vendit; bashkërendon punën e njësive administrative të sistemit të RTK-ës dhe zgjidh, brenda kompetencave të tij, mosmarrëveshjet midis tyre. Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së gjithashtu i raporton Bordit se paku një herë në muaj; përgatit dhe i paraqet Bordit një plan program vjetor i cili është në përputhshmëri me ligjin dhe standardet ndërkombëtare dhe mandatin e RTK-së siç është përcaktuar me këtë ligj; ndërmer masat korigjuese pas konstatimit nga ana e tij se ka pasur shkelje të standardeve, rregulloreve dhe ligjeve të aplikueshme, kryen punë tjera të përcaktuara me Statutin e RTK-së.¹⁰

Ndërsa zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës është e rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës , si dhe me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës . Referuar Kushtetutës dhe Ligjit për KGJK-në, ky institucion përbëhet nga 13 anëtarë, ku shtatë prej tyre do të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga gjyqësori, ndërsa gjashtë të tjerë zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Anëtarët emërohen për një mandat 5 vjeçar dhe zgjedhën në këtë mënyrë: 5 anëtarë janë gjyqtarë që

⁷ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave, neni 38.

⁸Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/l-046 për Radiotelevizionin e Kosovës.

⁹ Po aty, neni 32.

¹⁰ Po aty, neni 33.

zgjedhën nga gjyqësori, 4 anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve, 2 anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komunitetit Serb në Kosovë, 2 anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve të tjera.

PROCESI I PËRZGJEDHJES SË DREJTORIT TË AGJENCISË KUNDËR KORRUPSION (AKK)

Fillimisht, konkursi për pozitën e Drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsion ishte hapur më 20 maj, mirëpo për shkak se nuk kishte aplikuar asnjë kandidatë grua, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsion (tani e tutje: Komisioni për Legjislacion) kishte vendosur që i njëjti të përsëritet.

Rrjedhimisht, me 21 korrik 2021 Kuvendi i Republikës së Kosovës kishte rishpallur konkursin për zgjedhjen e Drejtorit të Agjencisë kundër Korrupsion. Në këtë konkurs kishin aplikuar 25 kandidatë, 24 prej të cilëve ishin burra, ndërsa vetëm 1 grua.

Trajnimi dhe diskutimi me ekspertët britanik, që ishin partnerë vlerësues në këtë proces, si dhe faza fillestare e shqyrtimit të aplikacioneve, ishte mbajtur me 21 tetor 2021. Nga 25 kandidatët që kishin aplikuar gjithsej, 4 prej tyre u diskualifikuan për shkak se nuk i përmbushnin kriteret formale për të vazhduar me procesin e intervistimit. Përkatësisht, një kandidat ishte diskualifikuar për shkak se i mungonte nostrifikimi, njëri prej tyre nuk kishte dëshmi për përvojë të punës, 1 kandidatë ishte diskualifikuar sepse ishte i dënuar për vepër penale, ndërsa 1 kandidatë (e vetmja grua) ishte diskualifikuar për shkak se ishte nën hetime.

Ndonëse Ligji për Agjencinë kundër Korrupsionit ¹¹parasheh se kandidati për drejtor të agjencisë duhet të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale, një kandidatë për këtë pozitë, përkatësisht e vetmja kandidatë grua në këtë proces, u përjashtua nga gara sepse kishte pasur raste të hapura në gjykatë. Me fjalë të tjera, e njëjta u diskualifikuar edhe pse njëri ndër kriteret e parapara në konkursin e publikuar në ueb-faqen e Kuvendit të Kosovës për këtë pozitë ishte se kandidati nuk duhet të jetë i dënuar për ndonjë vepër penale.

Kodi i Procedurës Penale përkufizon qartë nocionin e personit të dënuar. Në nenin 19, par. 1.6 të këtij kodi parashihet: "[...]personi i dënuar është personi që me

¹¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit, neni 8.

aktgjykim të formës së prerë të gjykatës është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale”.

Në lidhje me këtë, FOL i është drejtuar me kërkesë Kuvendit të Kosovës në lidhje me arsyet e përjashtimit të kandidates në fjalë. Ndërsa arsyeja e këtij diskualifikimi, sipas përgjigjes zyrtare të Kuvendit të Kosovës, ishte se: *“Komisioni ka vlerësuar se kandidatja në fjalë nuk e plotëson kriterin e përcaktuar me nenin 8 paragrafi 3.4 Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, ku ndër tjera përcaktohet “të ketë integritet të lartë moral. Sipas dokumentacionit të ofruar (Certifikata nga evidenca penale), nga kandidatja znj. Osmani, figuron se ka lëndë penale në procedurë”.*

Pra, Kuvendi ka paragjykuar integritetin moral të kandidates (për shkak të aktakuzës së ngritur ndaj saj), përkatësisht ka shkelur parimin e prezumimit të pafajësisë, e bashkë me të edhe dispozitat e Ligjit për Agjencinë Kundër Korrupsionit, ku qartë kërkohet që kandidati për Drejtor të AkK-së të mos jetë i dënuar për vepër penale (e jo të mos jetë nën ndjekje nga ana e prokurorisë).

Mbledhja e parë e komisionit ishte mbajtur me 22 tetor 2021. Në këtë mbledhje të pranishëm ishin: Kryetari i këtij komisioni, Adnan Rustemi, si dhe anëtarët: Hydajet Hyseni Kaloshi, Doarsa Kica, Artan Abrashi nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Driton Selmanaj nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Blerta Deliu dhe Hajdar Beqa nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), si dhe Erxhan Galushi nga Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës.

Në mbledhjen e parë të komisionit u vendos që të gjithë anëtarët të marrin pjesë nga fillimi deri në fund të intervistimit, apo të mos marrin pjesë fare në asnjë intervistë.

Ashtu siç është theksuar edhe në kornizën ligjorë të këtij raporti, sipas nenit 8 të Ligjit për Agjencinë Kundër Korrupsionit, përcaktohet se procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve më të mirë menaxhohen nga komisioni, ndërsa dy prej të cilëve janë vlerësuar si më të suksesshëm i propozohen kuvendit për votim.

Faza e intervistimit të kandidatëve për Drejtor të Agjencisë kundër Korrupsionit ishte planifikuar të fillonte me 29 nëntor 2021. Në këtë fazë, pra, ishin ftuar 21 kandidatë, ndërsa u intervistuan 20 prej tyre, meqë njëri ishte tërhequr nga gara. Prej të gjithë kandidatëve, asnjë nuk ishte grua.

Anëtarë të komisionit intervistues ishin deputetët: Adnan Rustemi (LVV), Driton Selmanaj (LDK), Hajdar Beqa (PDK), Dimal Basha (LVV), Hydajet Hyseni Kaloshi (LVV) dhe Artan Abrashi (LVV), si dhe ekspertët nga Ambasada Britanike: Anne Montgomery dhe Jan De Jonge.

Fillimisht, në bashkëpunim me ekspertët britanikë, u vendos për mënyrën e intervistimit dhe pyetjet që do t'i parashtraheshin secilit prej kandidatëve. Po ashtu, u vendos që poentimi nga ana e deputetëve të bëhet pas secilës intervistë, në prezencë të monitoruesve nga shoqëria civile.

Intervistat e 21 kandidatëve vazhduan deri me datën 6 dhjetor 2021. Koha e intervistimit ishte përafërsisht nga 1 orë për secilin kandidat. Pyetjet e parashtruara nga secili anëtarë i komisionit ishin në lidhje me mendimin strategjik, lidhshimin, komunikimin, menaxhimin, orientimin kah rezultatet, zhvillimin e vetes dhe të tjerëve, rrjetëzimin dhe integritetin. Pas çdo intervistimi, komisioni intervistues dhe ekspertët e Ambasadës Britanike kishin edhe 45 minuta kohë për të bërë poentimin. Pra përfundimi i intervistave dhe vlerësimeve ka zgjatur gjithsej nga 1 orë e 45 minuta për secilin kandidat.

Në fund të çdo interviste, anëtarët e komisionit në njërin anë, dhe ekspertët britanik në anën tjetër, kanë bërë poentimin e kandidatëve në mënyrë të pavarur. Pas çdo poentimi, anëtarët e komisionit dhe ekspertët britanik kanë diskutuar edhe në lidhje me arsyet e vlerësimit përkatës, dhe secili prej tyre është deklaruar në lidhje me prezantimet e kandidatëve.

Vlerësimet e kandidatëve nga ana e anëtarëve të Komisionit dhe nga ana e ekspertëve të Ambasadës Britanike (BDO), të cilët ishin nën cilësinë e monitoruesit në këtë proces, ishin të përafërta. Pesë kandidatët më të poentuar nga ana e panelit vlerësues të Kuvendit të Kosovës ishin: Yll Buleshkaj (33.7 pikë), Visar Krasniqi (33.5), Shaip Havolli (29.2), 4). Blerim Kelmendi (29), si dhe 5). Lulzim Ismaili (28.7).

Kandidatët më të poentuar nga ana e panelit vlerësues të Kuvendit të Kosovës janë paraqitur edhe në tabelën e mëposhtme.

	KANDIDATËT MË TË VLERËSUAR NGA KOMISIONI:	TOTALI I PIKËVE:
1.	Yll Buleshkaj	33.7
2.	Visar Krasniqi	33.5
3.	Shaip Havolli	29.2
4.	Blerim Kelmendi	29
5.	Lulzim Ismaili	28.7

Tabela 1. Kandidatët më të poentuar nga ana e komisionit vlerësues të Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e anëtarëve dhe numri total i pikëve për secilin prej tyre.

Ndërsa pesë (5) kandidatët më të poentuar nga ana e ekspertëve të Ambasadës Britanike ishin: Yll Buleshkaj (31.5); Lulzim Ismaili (29.5); Visar Krasniqi (29); Afrim Atashi (27.5) dhe Shaip Havolli (26). Kandidatët më të poentuar nga ana e ekspertëve të Ambasadës Britanike janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

	KANDIDATËT MË TË VLERËSUAR NGA EKSPERTËT E AMBASADËS BRITANIKE	TOTALI I PIKËVE
1.	Yll Buleshkaj	31.5
2.	Lulzim Ismaili	29.5
3.	Visar Krasniqi	29
4.	Afrim Atashi	27.5
5.	Shaip Havolli	26

Tabela 2. Kandidatët më të poentuar nga ana e ekspertëve të Ambasadës Britanike për zgjedhjen e anëtarëve dhe numri total i pikëve për secilin prej tyre.

Pra siç shihet edhe në tabelën e vendosur më sipër, Yll Buleshkaj ishte kandidati më i poentuar nga ana e komisionit si dhe nga ana e ekspertëve të BDO-së. Ndërsa kandidati i dytë më i poentuar nga ana e komisionit ishte kandidati Visar Krasniqi, ndërsa nga ana e BDO-së, ishte Lulzim Ismaili. Kandidati Visar Krasniqi renditet i treti nga ana e ekspertëve të BDO-së, ndërsa sipas vlerësimit të panelit intervistues, në këtë renditje qëndron Shaip Havolli.

Ndërkaq mënyra e poentimit nga ana e panelit intervistues të Kuvendit të Kosovës për secilin prej kandidatëve, si dhe nga ana e ekspertëve të Ambasadës Britanike, është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Emrat e kandidatëve	Komisioni i Kuvendit						Ekspertët e Ambasadës Britanike		Totali i pikëve
	Dimal Basha	Artan Abrashi	Adnan Rrustemi	Driton Selmanaj	Hydajete Hyseni	Hajdar Beqa	Anne Montgomery	Jan De Jonge	
Betim Elezaj	17	20	18	24	30	28	15	13	165
Sadri Abazi	22	20	24	26	28	25	18	21	184
Halil Cenaj	14	17	16	25	24	27	15	12	150
Shaip Havolli	24	26	27	35	26	37	26	26	227
Avni Muzliukaj	16	24	17	14	25	16	18	18	148
Muharrem Mustafa	22	22	21	27	27	28	21	18	186
Ekrem Demolli	11	19	18	23	20	24	13	12	140
Esad Ejupi	18	18	13	25	21	26	16	16	153
Afrim Atashi	17	30	24	35	25	36	26	29	222
Visar Krasniqi	34	34	32	28	33	40	29	29	259
Burim Sadiku	19	16	14	25	21	33	19	17	164
Osman Neziri	19	19	17	19	26	20	19	19	158
Yll Buleshkaj	32	36	35	32	36	31	32	31	265
Basri Kastrati	26	24	24	30	31	31	27	18	211
Avdyl Jerliu	21	25	16	25	20	26	21	19	173
Blerim Kelmendi	21	28	26	34	30	35	19	20	213
Lulzim Ismajli	25	27	27	32	28	33	31	28	231
Sali Rexhepi	23	22	20	24	33	35	18	21	196
Sadat Lekiqi	14	9	16	10	18	17	12	10	106
Ilir Islami	21	24	26	28	29	31	18	20	197

Tabela 3. Poenat e grumbulluara të kandidatëve nga ana e secilit anëtarë të panelit intervistues dhe nga ana e ekspertëve të Ambasadës Britanike.

Si përfundim, Yll Buleshkaj dhe Visar Krasniqi janë emrat e kandidatëve të cilët janë propozuar për Kuvendin e Republikës së Kosovës për votim.

Ndërkaq pas mbajtjes së seancës plenare të Kuvendit të Kosovës, Yll Buleshkaj u zgjedh Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsion, me gjithsej 62 vota të grumbulluara nga 66 në total.

Emri i Yll Buleshkaj mori vëmendjen e publikut dhe të mediave pas zgjedhjes së tij në këtë pozitë. Kjo për shkak se Zyra për Regjistrimin e Partive dhe Certifikim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në kohën sa udhëhiqej nga Yll Buleshkaj, kishte rekomanduar që të gjithë kandidatët për deputet, të certifikoheshin përnjëherë në një pako.

PROCESI I PËRZGJEDHJES SË TRE (3) ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË PAVARUR PËR MEDIA (KPM)

Në prill të vitit 2021, Komisioni i Pavarur për Media kishte hapur konkursin për përzgjedhjen e tre anëtarëve, dy nga radhët e komunitetit shqiptar dhe një nga radhët e komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës.

Në seancën plenare të datës 8 gusht, asnjëri nga kandidatët e propozuar për tre anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave: Hysni Mustafa, Luljeta Aliu-Krasniqi, Arbër Jashari, Vlorë Berisha, Fatih Basha dhe Maja Staletoviq, nuk i morën votat e nevojshme për t'u zgjedhur anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave. Gjithashtu, nga shoqëria civile është potencuar se ky proces, sidomos intervistimi i kandidatëve, ka qenë jo transparent, pasi që organizatat e shoqërisë civile që monitoronin procese të ngjashme në fjalë, nuk ishin ftuar fare.

Pas dështimit të votimit të kandidatëve në Kuvend, konkursi për zgjedhjen e tre anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave duhej të përsëritej, ndërkaq 5 ditë më vonë, me datë 13 gusht të vitit 2021, KPM hapi konkursin. Ky konkurs ka qenë i hapur deri më datën 29 gusht dhe të drejtë për të aplikuar, sipas nenit 10 të ligjit të KPM-së, kanë pasur të gjitha personalitetet e dalluara në fushat e “kulturës, artit, drejtësisë, kinematografisë, gazetarisë, biznesit, menaxhmentit, marrëdhënieve me publikun, marrëdhënieve ndërkombëtare, media dhe teknologji informative”¹². Në dokumentin për nominim është theksuar po ashtu që kandidatët duhet të kenë kredibilitet dhe autoritet të lartë njerëzor profesional dhe moral. Ishin gjithsej 22 kandidatë që kishin aplikuar në thirrjen për nominim.

Më vonë, në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të datës 23 nëntor 2021, formohet Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave, për zgjedhjen e tre anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave. Nga Lëvizja Vetëvendosje, nënkryetar i dytë i komisionit ishte

¹² Pakoja për nominim për tre anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3379

deputeti Njazi Isaku, ndërsa anëtarët tjerë, deputetët Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Fitim Haziri, Jeta Statovci dhe Valon Ramadani. Zëvendëskryetar i parë i komisionit ad-hoc nga Partia Demokratike e Kosovës ishte Hajdar Beqa dhe Ariana Musliu-Shoshi nga LDK ishte Agim Veliu dhe nga AAK ishte Time Kadriaj.

Takimi i parë i këtij Komisioni është mbajtur më 13 dhjetor, ku u shqyrtua lista e kandidatëve. Dy prej kandidatëve janë diskualifikuar për shkak që kishin arritur moshën e pensionimit, ndërsa njëra ishte diskualifikuar pasi që tashmë ishte anëtare e Bordit të RTK-së. Gjatë këtij takimi u morr vendim që gjatë procesit të intervistimit të jenë të pranishëm deputetët e njëjtë dhe ata që nuk kanë mundësi të marrin pjesë në intervistim të deklarohen që nga fillimi, pasi që mungesa e tyre nuk duhet ta determinoj poentimin e kandidatëve. Gjithashtu, anëtarët e pranishëm në takim u dakorduan që pyetjet dhe kohëzgjatjen e intervistave ta caktojnë në ditën e intervistimit të kandidatëve rreth një orë para se të filloj ky proces.

Më datën 16 dhjetor 2021, janë intervistuar të gjithë kandidatët që i kanë plotësuar kriteret teknike. Nga Komisioni ishin të pranishëm këta deputetët: Hajdar Beqa, Agim Veliu, Njazi Isaku, Jeta Statovci, Time Kadriaj, Fitim Haziri, Ariana Musliu Shoshi, Fidan Jilta dhe Valon Ramadani.

Fillimisht u diskutuan pyetjet e intervistimit për të cilat u dakorduan të gjithë deputetët. Shqetësues ishte fakti se jo të gjithë ishin të pajtimit që poentimi të ishte i hapur dhe që të diskutoheshin arsyet e poentimit, me arsyeshmërinë që ky proces merr kohë dhe që poentimit duhet të jetë anonim. Ky diskutim u hodh në votim nga Zëvendëskryetari Hajdar Beqa dhe si rezultat u vendos që poentimi të mos diskutohej pas secilës intervistë.

Të pranishëm në intervistë ishin gjithsej 16 kandidatë, 4 prej tyre ishin nga komuniteti jo shumicë. Duhet të theksohet që në intervistë nuk janë paraqitur 3 kandidatë, vetëm njëri prej tyre kishte informuar që tashmë ishte i angazhuar në një punë tjetër.

I gjithë procesi i intervistimit ka zgjatur një ditë dhe mund të thuhet që ka shkuar në rregull, që i bie që të gjithë anëtarët ishin korrekt në paraqitjen e pyetjeve të tyre dhe në respektimin e kohëzgjatjes së intervistave për secilin kandidatë.

Pas përfundimit të të gjithë intervistave, anëtarët e Komisionit i përfunduan të gjitha poentimet për secilin kandidatë dhe më pas zyrtarja nga Zyra Koordinuese e Komisionit së bashku me disa prej anëtarëve i mblodhën pikët për secilin kandidatë. Si rrjedhojë, kandidatët më të poentuar nga ana e Komisionit ishin: Besnik Berisha, Jeton Mehmeti, Visar Xani dhe Luljeta Aliu Krasniqi. Ndërkaq kandidatët më të vlerësuar nga radhët e komuniteteve ishin Fatih Basha dhe Lendrit Qeli.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur mënyrat e poentimit të të gjithë kandidatëve, nga ana e panelit intervistues.

	Kandidati/ja	Totali
1.	Fatih Basha	98.11
2.	Besnik Berisha	95.67
3.	Jeton Mehmeti	95.11
4.	Visar Xani	84.11
5.	Luljeta Aliu Krasniqi	82.11
6.	Lendrit Qeli	81.00
7.	Hysni Mustafa	80.67
8.	Lindita Fazliu	75.11
9.	Bjeshka Gusinja	74.89
10.	Gurakuq Kuqi	73.44
11.	Anita Muriqi	64.44
12.	Jelena Simic	63.56
13.	Maja Slavic Staletovic	63.22
14.	Valdete Ferati Pllana	61.56
15.	Melisa Ceman	56.33
16.	Driton Morina	55.78

Tabela 4: Tabela e poentimit të kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media.

Me datën 21 dhjetor 2022, Komisioni Ad-hoc i rekomandon Kuvendit¹³ për votim listën e kandidatëve për dy anëtarë të KPM-së, nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar dhe për një anëtar nga radhët e komuniteteve joshqiptare, të radhitur sipas rezultateve të poentimit, të cilët ishin Besnik Berisha, Jeton Mehmeti, Visar Xani, Luljeta Aliu-Krasniqi, Fatih Basha dhe Lendrit Qeli.

Kandidatët më të poentuar nga ana e anëtarëve të komisionit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

¹³ Kuvendi i Republikës së Kosovës; [Rekomandim i Komisionit Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave, për zgjedhjen e tre anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave - Kuvendi i Kosovës \(kuvendikosoves.org\)](#)

	Kandidatët më të vlerësuar nga radhët e komunitetit shumicë	Kandidatët më të vlerësuar nga radhët e komunitetit jo shumicë
1.	Besnik Berisha	Fatih Basha
2.	Jeton Mehmeti	Lendrit Qeli
3.	Visar Xani	
4.	Luljeta Aliu Krasniqi	

Tabela 5. Kandidatët më të poentuar nga ana e Anëtarëve të Komisionit nga radhët e komunitetit shumicë dhe nga radhët e komuniteteve tjera.

Në seancën plenare të datës 21 janar 2022, Kuvendi votoi tre anëtarët e KPM-së, të cilët ishin: Besnik Berisha, Jeton Mehmeti dhe Fatih Basha. Ndërkaq, mandati i tyre është përzgjedhur me short nga komisioni ad-hoc, ku Besnik Berisha është zgjedhur me mandat katër vjeçar, ndërsa Fatih Basha dhe Jeton Mehmeti me mandat tre vjeçar. Më detajisht, për përzgjedhjen e kandidatëve të propozuar për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komunitetit shumicë shqiptare, kanë marrë pjesë 83 deputetë. Tri nga këto fletëvotime kanë qenë të pavlefshme. Ndërkaq, Besnik Berisha ka marrë 70 vota, Jeton Mehmeti 56 vota, Visar Xani 16 vota dhe Luljeta Aliu Krasniqi ka marrë 12 vota. Kurse, për kandidatët e propozuar për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur të Mediave të komuniteteve jo-shqiptare në votim kanë marrë pjesë po ashtu 83 deputetë, të pavlefshme ishin katër fletëvotime. Fatih Basha kishte marrë 75 vota, ndërsa Lendrit Qeli katër vota.

PROCESI I PËRZGJEDHJES SË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË RADIO TELEVISIONIT TË KOSOVËS (RTK)

Lëvizja FOL ka monitoruar fazën e fillestare dhe fazën e intervistave të përzgjedhjes së kandidatëve për Drejtor të Përgjithshëm të Radio Televizionit të Kosovës. FOL nuk kishte monitoruar fazën e testimit, për shkak se nuk kishte pranuar kurrfarë njoftimi nga bordi i këtij institucioni në lidhje me kohën e mbajtjes së testeve.¹⁴

Konkursi për përzgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Radio Televizionit të Kosovës është shpallur nga bordi i këtij institucioni me 2 shkurt 2021. Kjo për shkak

¹⁴ Gjatë komunikimit me zyrtarët përgjegjës të këtij institucioni, arsytimi i tyre ka qenë si vijon: “Zakonisht për çdo mbledhje ne e bëjmë edhe njoftimin në ueb të RTK-së dhe linkun i’a dërgojmë monitoruesve, por në këtë rast ka ndodh një keqkuptim dhe nuk është publiku njoftimi në ueb”.

se, javë më parë, Bordi kishte shkarkuar ish-drejtorin e këtij institucioni, për shkak se dyshohej për shkelje të shumta të Ligjit për RTK-në.

Komisioni Vlerësues ishte në përbërjen e plotë të Bordit të RTK-së, si: *Besnik Boletini - kryetar; Arta Berisha - nënkryetare; dhe anëtarët Safet Kabashaj, Fatime Lumi Qehaja, Driton Hetemi, Albulena Mehmeti, Bekim Sele, Shukrije Rama dhe Ivan Radulovic.*

Me datën 2 shkurt, Bordi i RTK-së miratoi kriteret e konkursit për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së, të cilat ishin: kualifikim superior profesional në drejtimin përkatës (media ose fusha të tjera relevante); njohuri mbi funksionimin e përgjithshëm të RTK-së; të jetë person me integritet të lartë personal dhe profesional; të ketë njohuri të spektrit medial transmetues në Kosovë, rajon dhe më gjerë; të ketë së paku 5 vjet përvojë pune në menaxhimin e mediave ose në fusha të tjera relevante; aftësi të dëshmuara në organizim, udhëheqje dhe planifikim; standard i lartë i gjuhës shqipe ose/dhe gjuhës serbe në të folur dhe në të shkruar; njohja e mirë e gjuhës angleze është përparësi; njohje e shkëlqyeshme e proceseve të digjitalizimit dhe proceseve tjera të teknologjisë bashkëkohore; si dhe aftësi për të bashkëvepruar me maturi dhe ndjeshmëri me kolegë dhe palë.

Në konkurs ishte përcaktuar se data e fundit e pranimit të aplikacioneve ishte 21.02.2022, ora 16:00 dhe se aplikacionet e dërguara me vonesë nuk do të pranohen. Pra aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.

Brenda afatit kohorë të përcaktuar me konkurs kishin aplikuar 16 kandidatë, 12 burra e 4 gra. Këta kandidatë ishin: *Adriana Kutllovci, Arben Berisha, Bekim Hasani, Burhan Lata, Fadil Hoxha, Fahredin Shehu, Fisnik Derguti, Fitore Miftari, Gjergj Filipaj, Hysen Hundozi, Mehmet Kalisi, Orhan Hajrizi, Remzije Zeqiraj, Shkumbin Ahmetxhekaj, Valentina Saraçini, Zenel Hajrizi.* Prej këtyre kandidatëve, 4 nuk i kishin plotësuar kushtet për të kaluar në fazat tjera të intervistimit.

Pavarësisht që ishte e paraparë edhe me konkurs që dokumentet e pakompletuara nuk do të merren parasysh, komisioni vlerësues në fazën e shqyrtimit të dokumentacioneve për të përpiluar listën e ngushtë, i'u ka dhënë një mundësi shtesë kandidatëve për plotësimin e dokumentacionit, në mënyrë që të vazhdojnë garën. Për këtë vendim, Bordi u konsultua edhe me zyrtarin ligjor të RTK-së.

Mundësia për plotësimin e dokumentacioneve i'u është dhënë 8 kandidatëve. Këta kandidatë ishin: *Burhan Lata, Mehmet Kalisi, Fitore Miftari, Zenel Hajdini, Hysen Hundozi, Orhan Hajrizi, Fahredin Shehu dhe Arben Berisha* u është kërkuar që të sjellin dokumentet e munguara në mënyrë që të njëjtit të kalojnë në fazën e testimit.

Pas mundësisë së dytë që u dha kandidatëve nga Komisioni Vlerësues, 4 kandidatë (*Hysen Hundozi, Arben Berisha, Orhan Hajrizi, Fahredin Shehu*) arritën që ta kompletojnë dokumentacionin dhe të kalojnë në fazën e testimit me shkrim. Pra gjithsej 12 kandidatë i kishin plotësuar kushtet për të kaluar në fazat tjera të intervistimit.

Kandidatët që kaluan fazën e parë i'u nënshtruan testit me shkrim me datë 7 mars. Testimi, i cili zgjati 1 orë, përmbante pyetje rreth kompetencave, përgjegjësive dhe detyrave të drejtorit të përgjithshëm të RTK-së dhe njohurive të përgjithshme për RTK. Ndërkaq nga 12 kandidatë që kishin të drejtë të hynin në test, kandidatja Remzije Zeqiraj nuk ishte paraqit në këtë fazë.

Gjatë kohës sa kishte zgjatë testi në sallë kishin qëndruar vetëm dy anëtarët e Bordit, Fatime Lumi - Qehaja dhe Shukrije Rama. Ndërkaq me përfundimin e testit dhe largimin e kandidatëve në sallë ishin kthyer tërë anëtarët e Komisionit vlerësues të cilët edhe kishin filluar me kontrollimin e testeve të 11 kandidatëve.

Intervistimi i kandidatëve ishte planifikuar të bëhet me 19 mars 2022. Në intervistë kishin të drejtë të hynin vetëm kandidatët që kishin arritur mbi 50 % të pikëve nga testimi me shkrim, e ata ishin: *Shkumbin Ahmetxhekaj* që ka marrë 80.7 % të pikëve nga testi me shkrim; *Bekim Hasani* që ka marrë 79.4% të pikëve; *Fadil Hoxha* - 73.7%; *Hysen Hundozi* - 70.9%; *Gjergj Filipaj* - 69.3%; *Arben Berisha* - 65.8%; *Fisnik Dërguti* - 52.2% dhe *Adriana Kutllovci* - 50%. Pra gjithsej 8 kandidatë, 7 prej të cilëve ishin burra e vetëm 1 grua.

Në intervistë janë paraqitur vetëm pesë kandidatë. Tre kandidatë që kanë qenë në testin me shkrim (Fisnik Durguti, Fadil Hoxha dhe Hysen Hundozi) nuk janë paraqitur në intervistë.

Intervistimi i kandidatëve u zhvillua më 19 mars 2022, në zyrat e Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës. Intervistat e kandidatëve kanë zgjatur nga 30 minuta dhe totali/maksimumi i pikëve të intervistimit ka qenë 100, ku secila pyetje ka pasur nga 20 pikë. Por, bordi ka lejuar që disa prej kandidatëve të flasin më tepër se 30 minuta, përkundër faktit që në fillim ishte caktuar limiti i intervistave të jetë 30 minuta.

Por, Bordi pasi që kandidatit të tretë më rend, Bekim Hasanit, i janë dhënë 8 minuta shtesë, atëherë edhe dy kandidatëve të tjerë pas tij, u është thënë se u lejohet ta tejkalojnë kohën e intervistave.

Në fund të intervistimit, dy kandidatët më të poentuar për këtë pozitë ishin: *Shkumbin Ahmetxhekaj*, me gjithsej 158,7 pikë, si dhe *Bekim Hasani* me 155,6 pikë në total.

Ndërsa poentimet e secilit kandidatë të intervistuar nga paneli intervistues, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Kandidati/ja	Pikët e testit	Pikët e intervistës	Totali
Shkumbin Ahmetxhekaj	80,7	70,0	158,7
Bekim Hasani	79,4	76,2	155,6
Gjergj Filipaj	69,3	64,1	133,4
Arben Berisha	65,8	65,2	131,0
Adriana Kutllovci	50,0	40,1	90,01

Tabela 5. Poenat e grumbulluara në fazën e testimi dhe të intervistave për secilin nga kandidatët për Drejtor të Përgjithshëm të Radio Televizionit të Kosovës.

Ndërkaq në mbledhjen e mbajtur me 22 mars 2022, Bordi i RTK-së ka vendosur të rikthej në pikën zero procesin e përzgjedhjes së Drejtorit të RTK-së. Sipas anëtarëve të Bordit, kjo ka ardhur për shkak të mungesës së bazës së qartë ligjore që do të garantonte përfundimin e procesit. Rrjedhimisht, për të evituar shkeljet ligjore, Bordi i RTK-së e ka përmbyllur procesin e konkursit duke mos e votuar asnjë kandidat për Drejtor të Përgjithshëm të RTK-së.

Sipas Bordit, udhëzimi i përdorur deri tani për zgjedhjen e drejtorit të përgjithshëm të këtij institucioni bie ndesh me vetë Ligjin për Radio Televizionin e Kosovës. Udhëzimi përcakton se 3 anëtarë mund të jenë në komisionin vlerësues dhe vlerësimin final ia dërgojnë bordit për aprovim, ndërkaq Ligji për RTK-në e thotë qartë se Drejtori i RTK-së duhet të emërohet me 2/3 të votave të anëtarëve të bordit dhe përcakton qartë se anëtarët e bordit nuk duhet të ndikohen nga asnjë palë në vendimin e tyre, pra as nga një komision i tillë prej tre anëtarëve.

PROCESI I PËRZGJEDHJES SË DY (2) ANËTARËVE TË KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS (KGJK)

Kuvendi i Republikës së Kosovës në tetor të vitit 2021 kishte hapur konkursin për zgjedhjen e dy anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radhët e komuniteteve jo shumicë në Kosovë, një për komunitetin serb dhe një për komunitetet tjera jo shumicë.

Anëtarë të komisionit intervistues ishin deputetët e Komisionit për Legjislacion, përkatësisht: *Adnan Rrustemi (LVV), Driton Selmanaj (LDK), Hydajet Hyseni Kaloshi (LVV) dhe Artan Abrashi (LVV), Hajdar Beqa (PDK), Besnik Tahiri (AAK), Blerta Deliu (PDK), Ljubinko Kardacic (Lista Serbe) dhe Erxhan Galushi (Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës), ndërsa munguan Doarsa Kica-Xhelili dhe Dimal Basha.*

Në këtë konkurs kishin aplikuar gjithsej 5 kandidatë (*Dragica Jakovljevic, Milena Đerić, Fahret Vellija, Ahmet Imami, Osman Cucovic*), 2 prej të cilëve nga komuniteti serb dhe 3 nga komunitet tjera jo shumicë. I gjithë procesi i intervistimit zgjati rreth 1 ore.

Faza e intervistimit të kandidatëve kishte filluar me 29 nëntor 2021. Në intervistë, ndonëse ishin të ftuar 5 kandidatë, arritën vetëm 4 prej tyre, meqë njëri prej tyre (Ahmet Imami) për shkaqe subjektive u tërhoq nga gara.

Para fillimit të intervistave, përkatësisht 30 minuta më parë, komisioni i kishte përpiluar pyetjet që do t'u parashtraheshin kandidatëve. Gjithsej u përgatiten 11

pyetje, në atë mënyrë që secili prej kandidatëve të zgjedh përmes shortit nga 3 pyetje.

Pyetjet e parashtruara kishin të bënin me përfundimin e mandatit të gjyqtarëve, detyrat dhe kompetencat e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përbërja dhe funksionet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sanksionet disiplinore që mund të ju shqiptohen gjyqtarëve, si dhe në lidhje me imunitetin e gjyqtarëve. I gjithë procesi i intervistimit kishte zgjatur më pak se një orë.

Fazës së intervistimit fillimisht i janë nënshtruar kandidatët që kanë aplikuar për pozitën e anëtarit të KGJK-së nga radhët e komunitetit serb, e pastaj për komunitetet tjera.

Pas intervistimit, me më së shumti pikë komisioni e kishte vlerësuar Milena Đerić (89 pikë) dhe Fahret Vellija (84 pikë).

Ndërsa gjithsej pikët e grumbulluara nga ana e kandidatëve që kishin aplikuar për këto pozita, është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Kandidati/ja	Totali i pikëve
Dragica Jakovljevic	61
Milena Deric	89
Fahret Vellija	84
Osman Cucovic	69

Tabela 6. Poenat e grumbulluara nga kandidatët për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radhët e komuniteteve jo shumicë.

Katër kandidatët të renditur sipas poentimit më të lartë i janë propozuar Kuvendit për votim. Ndërsa në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës, të mbajtur me 21 janar 2022, Fahret Vellija është zgjedhur anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa kandidatët e komunitetit serb nuk kishin marrë votat e mjaftueshme për tu zgjedhur në këtë pozitë, prandaj konkursi për këtë pozitë duhet të përsëritej.

REKOMANDIME

Duke i analizuar të gjitha proceset e komisioneve parlamentare dhe procesin e Bordit të RTK-së për përzgjedhjen e pozitive përkatëse, si dhe duke marrë parasysh konkluzionet procedurale dhe sistematike të të gjitha proceseve veç e veç, FOL rekomandon:

- Të zhvillohen procese transparente dhe llogaridhënëse të rekrutimit, me pjesëmarrjen e gjerë të shoqërisë civile, ku votimet nga ana e anëtarëve të panelit intervistues të jenë publike.
- Pas votimit, secili nga anëtarët e panelit intervistues të jap arsytet në lidhje me poentimet përkatëse për secilin kandidatë.
- Pas çdo procesi rekrutues, të përgatitet raport nga ana e komisioneve përkatëse mbi mbarëvajtjen dhe detajet e gjithë procesit.
- Të zbatohen drejt dispozitat ligjore që rregullojnë çështjen e përmbushjes së kushteve procedurale për aplikim në pozitë përkatëse, përkatësisht interpretimi të saktë juridik të kushteve të cilat kërkohen nga kandidatët.
- Të qartësohet përvoja menaxheriale e nevojshme që kërkohet për aplikimin e kandidatëve për pozitë përkatëse.
- Të përvetësohen përvojat e mira dhe praktikët e krijuara gjatë bashkëpunimit me ekspertët britanik.
- Të gjithë kandidatët të trajtohen në mënyrë të barabartë në të gjitha pyetjet e parashtruara, duke përfshirë edhe pyetjet shtesë.
- Listat e kandidatëve të cilët i përmbushin kriteret formale për pozitë e larta shtetërore, ti dërgohen Agjencisë kundër Korrupsion për dhënien e opinionit ligjor sa i përket konfliktit të mundshëm të interesit.
- Të standardizohen dhe të unifikohen procedurat e rekrutimit të pozitive të larta shtetërore.